

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË BAJRAM CURRI

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Bajram Curri**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 160, datë 09.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 772/8, datë 09.12.2014, i ka rekomanduar z. Agron Demushi, Kryetar i Bashkisë Bajram Curri, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje: U konstatua se nuk janë marrë masa për implementimin e plotë të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”. Nuk është miratuar në Këshillin Bashkiak Rregullorja e Brendshme për funksionimin e administratës, dhe punohet me rregulloren e vjetër të miratuar në vitin 2001.

Rekomandimi: Bashkia B. Curri të marrë masa për implementimin e plotë të kërkesave të ligjit “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” dhe të hartohet e të miratohet në Këshillin Bashkiak Rregullorja e Brendshme e re për funksionimin e administratës.

Menjëherë

2. Gjetje: Nuk janë kontabilizuar dhe arkëtuar disa nga detyrimet e rekomanduara nga KLSH, Auditi i Prefekturës Kukës dhe APP Tiranë, për vlerën 279,324 lekë, me mundësi arkëtimi, pasi debitorët janë punonjës të bashkisë, në kundërshtim me VKM nr. 545, datë 11.8.2011, me pikën 16 të VKM nr. 1619, datë 02.7.2008.

Rekomandimi: Drejtoria e Financës e Bashkisë Bajram Curri të marrë masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të prapambetura të rekomanduara nga auditet e mëparshme, të kryera nga KLSH, Auditi i Prefekturës Kukës dhe APP Tiranë, për vlerën **279,324 lekë**, përkatësisht B.B. 21,000 lekë, A.Gj. 14,860 lekë, P.M. 14,610 lekë, V.D. 10,000 lekë, M.S. 25,000 lekë, H.Gj. 50,000 lekë, V.H. 50,000 lekë dhe H.I. 50,000 lekë, dhe 43,854 lekë nga 5 punonjësit e bashkisë.

Deri me 31.01.2015

3. Gjetje: Është konstatuar se çerdhja e qytetit të Bashkisë Bajram Curri frekuentohet mesatarisht nga 10 fëmijë, ndërkohë që shërbejnë 6 punonjës mbi normativën e lejuar, në kundërshtim me VKM nr. 323, datë 14.6.1993 “*Normat për vendosjen e personelit ne çerdhe*” dhe me UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”.

Rekomandimi: Bashkia të marrë masa për reduktimin e organikës të çerdhes qytetit, sipas normativave ligjore, duke bërë ndërprerjen e pagesave për personat mbi normativë.

Deri me 31.01.2015

4. Gjetje: Është konstatuar se në funksionimin e administratës ka persona që kryejnë dy detyra njëherësh si: arkëtarja e Bashkisë ka kryer edhe detyrën e magazinieres, përgjegjësjë e taksave vendore mbulon dhe detyrën e përgjegjëses së QKR, përgjegjësi i policisë bashkiake mbulon dhe detyrën e INUV, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 15 etj.

Rekomandimi: Bashkia Bajram Curri, të marrë masa për heqjen nga ngarkesa e detyrave të dubluara të kryera nga një punonjës, duke caktuar për çdo detyrë punonjës in përkatës të miratuar në organikë, për arkëtarin, magazinierin, përgjegjësin e taksave vendore, punonjës in e QKR, përgjegjësin e policisë bashkiake k/inspektorin e INUV.

Deri me 31.12.2014

5. Gjetje: Nuk është bërë hyrje 1 kompjuter, sipas urdhër shpenzimit nr. 107, datë 21.6.2013 dhe faturës nr. 3819, datë 6.6.2013, në kundërshtim me nenin 13 pika c, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandimi: Sektori i Financës të Bashkisë të bëjë hyrje 1 kompjuter, sipas urdhër shpenzimit nr. 107, datë 21.6.2013 (vlera të përcaktohet saktë sipas urdhër shpenzimit).

Deri me 31.12.2014

6. Gjetje: Mungon programi i punës për makinat e rënda të pastrimit, çka ndikon në shfrytëzimin dhe efektivitetin e tyre. Makineritë e rënda të pastrimit paraqesin normativa të larta të karburantit për vitin 2013 dhe në vazhdim, çka ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve të karburantit, në kundërshtim me ligjin nr.10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandimi: Bashkia Bajram Curri të hartojë program pune për makinat e pastrimit, për efekt të shfrytëzimit tyre, si dhe të rivlerësojë normativat e karburantit me komision pasi ato rezultojnë të larta, për efekt të uljes së shpenzimeve të tyre.

Deri me 31.12.2014

7. Gjetje: Është konstatuar tejkalim i peshës specifike të pagave për vitin 2012, pasi sipas të dhënave nga “Transferta e pakushtëzuar” për koston e personelit administrativë janë përdorur 28.7% nga 25% që është e lejuar duke vepruar në kundërshtim me kriteret e UMF nr. 2/1, datë 15.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, shtojca 5, ku ndër të tjera thuhet: Për Bashkitë që kanë deri në 20000 banorë, përdorin deri në 25% të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrative.

Rekomandimi: Zyra e Financës, Bashkia Bajram Curri të marrë masa për përdorimin e tranfertës së pakushtëzuar, për koston e personelit administrativë në përputhje me limitet e përcaktuara në UMF, duke shmangur tejkalimin.

Në vijimësi

8. Gjetje: a- Nuk i janë dërguar Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit (për pasurinë e paluajtshme), kjo bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat tatimore” i ndryshuar.

b- Për subjektet që nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nuk janë zbatuar procedurat

tatimore për arkëtimin e detyrimeve, duke llogaritur dhe masa administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008) të depozitohet kallëzim penal në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pikës 130-132, të Udhëzimit Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit Penal i RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

c- Nuk janë dërguar pranë Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore".

Rekomandimi: Zyra e Tatim-Taksave të Bashkisë B.Curri të marrë masa:

a- Ti dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit (për pasurinë e paluajtshme);

b- Për subjektet që nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të zbatohen procedurat tatimore për arkëtimin e detyrimeve, duke llogaritur dhe masa administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit);

c- Të dërgohen pranë Bankave urdhërat e bllokimit të llogarive.

Brenda datës 31.03.2015

9. Gjetje: Është konstatuar mungesë të ardhurash deri më datën 31.06.2014 për taksën e ndërtesës që paraqitet në vlerën 1,576,000 lekë dhe për tarifën e pastrimit në vlerën 474,000 lekë.

Rekomandimi: Zyra e Tatim-Taksave e Bashkisë Bajram Curri, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara të debitorëve deri më datën 31.12.2014 për taksën e ndërtesës në vlerën **1,576,000 lekë** dhe për tarifën e pastrimit në vlerën **474,000 lekë**.

Brenda datës 31.02.2015

10. Gjetje: Nuk janë kryer arkëtimet e detyrimeve në shumën 961,000 lekë që u përket 31 subjekteve, që ushtrojnë aktivitet të pa licencuar, dhe ndaj tyre nuk janë aplikuar masa administrative gjobë në masën 25,000 lekë, sipas nenit 112 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore". Nuk janë zbatuar procedurat tatimore për mbylljen e veprimtarisë në rast mos arkëtimi nga ana e tyre në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" dhe ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 "Për Procedurat Tatimore" neni 41.

Rekomandimi: Bashkia Bajram Curri, të marrë masat për arkëtimin e detyrimit në shumën **961,000 lekë** që u përket 31 subjekteve, të cilët ushtrojnë aktivitet të pa licencuar, në të kundërt të aplikohet masa administrative gjobë në masën 25,000 lekë.

Brenda datës 31.02.2015

11. Gjetje: Nuk janë kryer inventarizimet e dosjeve të 341 subjekteve, që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Bajram Curri, duke i përditësuar dhe plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm si: Njoftim vlerësimi tatimor dhe Dokumenti i Pagesës së detyrimit, (Mandat arkëtimi), lejet e dhëna nga QKR për ushtrimin e aktivitetit, certifikatat, dokumentet e blerjes së kasës fiskale, deklaratat parashikuese të qarkullimit vjetor, genplanet apo planimetritë (kjo për taksën e ndërtesave për familjarët), akt-konstatimet apo akt-verifikimet për rivlerësimin tatimor, për ndërprerjet e përkohshme ose mbylljet e

aktivitetit, të konfirmuara dhe nga Policia Bashkiake, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në RSH", neni 29, -Dosja e detyrimeve tatimore, pika 1.

Rekomandimi: Zyra e Tatim Taksave të Bashkisë të kryejë inventarizimin e dosjeve të 341 subjekteve, që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Bajram Curri, duke i përditësuar dhe plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm.

Brenda datës 31.01.2015

12. Gjetje: Nuk janë dërguar zyrtarisht zyrës së Financës, listat e debitorëve për detyrimet fiskale, me qëllim kontabilizimin e detyrimit, llogaritjen e kamat vonesave dhe ndjekjen ligjore të ekzekutimit të tyre në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Rekomandimi: Zyra e Tatim Taksave Bashkisë të dërgojë zyrtarisht zyrës së Financës, listën e debitorëve për detyrimet fiskale, me qëllim kontabilizimin e detyrimit, llogaritjen e kamat vonesave dhe ndjekjen ligjore të ekzekutimit të tyre.

Në vijimësi

13. Gjetje: Është konstatuar se zyra e Tatim-Taksave të Bashkisë Bajram Curri, ka aplikuar dënim me gjobë nga 5% në muaj, por jo më shumë se 25% të detyrimit për taksën për pagesën e vonuar të kësteve të detyrimeve, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", kjo është zbatuar vetëm për një pjesë subjektet të cilat nuk zbatojnë afatet e përcaktuara për pagesat e taksave.

Rekomandimi: Zyra e Tatim-Taksave të Bashkisë Bajram Curr, të aplikojë dënim me gjobë nga 5% në muaj, por jo më shumë se 25% të detyrimit për taksën, për pagesën e vonuar të kësteve të detyrimeve, për subjektet të cilat nuk zbatojnë afatet e përcaktuara.

Në vijimësi

14. Gjetje: Në punësimin e punonjësve të Policisë Bashkiake, nuk janë zbatuar procedurat e përzgjedhjes nga komisioni përkatës dhe nuk kanë kaluar formimin në Akademinë e Policisë së Rendit, në kundërshtim me kriteret e urdhrin të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 "Për miratimin e rregullores "TIP" të policisë Bashkiake dhe të Komunës", pika 1, 2, 4 dhe 5.

Rekomandimi: Zyra e Burimeve Njerzore e Bashkisë Bajram Curr, të marrë masa, për verifikimin e procedurave të përzgjedhjes së punonjësve të policisë dhe kualifikimin e tyre në zbatim të kërkesave të akteve ligjore.

Brenda datës 31.01.2015

15. Gjetje: Nuk janë kryer arkëtimet e detyrimeve në vlerën 67,000 lekë nga Policia Bashkiake për arkëtimin e 16 gjobave të vendosura dhe të pa paguara deri më datën 30.06.2014, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", përkatësisht nenet 9, 22 dhe 30.

Rekomandimi: Policia Bashkiake të marrë masa, për arkëtimin e 16 gjobave të pa paguara deri më datën 30.06.2014 për vlerën **67,000 lekë** sipas listës të trajtuar në procesverbalin përkatës.

Brenda datës 31.12.2014

16. Gjetje: Autoriteti kontraktor nuk ka bërë arkivimin e kontratës, në kundërshtim me nenin 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Rekomandimi: Bashkia B. Curri të marrë masat që pas përfundimit të procedurave të prokurimit të kryej inventarizimin e dosjeve.

Në vijimësi

17. Gjetje: Aplikimet për leje punimesh dhe miratimi i lejeve zhvillimore/ndërtimi, për periudhën 2012, 2013 dhe 6- mujorin e pare 2014 nuk janë dhënë sipas vendimit nr. 139, datë 22.02.2012, për disa shtesa në vendimin nr. 502, datë 13.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar, me anekset bashkangjitur, për arsye se nuk ka Plan të Detajuar Vendor dhe Plan të Përgjithshëm Vendor.

Rekomandimi: Autoriteti Vendor i Planifikimit të marrë masa për hartimin e miratimin e Planit Përgjithshëm Vendor. Bashkia B. Curri të mos jepë leje ndërtimi apo zhvillimi, pa përfunduar më parë plani territorial vendor nga autoritetet përkatëse të planifikimit, i cili të përmbush standardet teknike e procedurale.

Në vijimësi

18. Gjetje: Sektori i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit nuk ka kryer rillogaritjet e vlerës së investimit në të gjitha procedurat e dhënies së lejeve të përdorimit.

Rekomandimi: Bashkia B. Curri të marrë masa që të plotësojë me staf teknik Sektorin e Planifikimit të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, për llogaritjen dhe sqarimin e detyrimeve që i ngarkon kuadri ligjor “Për planifikimin e territorit”, në lidhje me transparencën, koordinimin, bashkërendimin që duhet bërë gjatë proceseve të ndryshme të hartimit dhe miratimit të instrumenteve të planifikimit dhe dhënies së lejeve.

Në vijimësi

19. Gjetje: Emërimi i punonjësit në strukturën e INUV është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe Inspektorëve të Inspektoratit Urbanistik Vendor”, pasi inspektori nuk ka kualifikimin e kërkuar. U konstatua mos zbatimi i kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar dhe në VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV”, i ndryshuar.

Rekomandimi: Inspektori i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, të marrë masa në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, për të evidentuar e kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme ndërtimet pa leje, duke aplikuar gjyba dhe masa pas vijuese ndëshkimore ndaj subjekteve ndërtuese të kundërligjshëm.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative në të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbarimor, për arkëtimin e vlerës **15,739,640 lekë dëm ekonomik**, përkatësisht:

1. Gjetje: Për vitin 2012, 2013 dhe 6-mujorin e parë të vitit 2014, për 3 ambiente të Pallatit Kulturës të dhëna me qira, u konstatuan shkelje për vlerën **586,800 lekë mungesë të ardhurash**, pasi është aplikuar më pak për 100 lekë/m² tarifa ligjore të qirave në vend të çmimit 200 lekë/m² që duhej, në 1 rast është shmangur pagesa truallit funksional, ka mos arkëtime të qirave për vitin 2014 si dhe janë anashkaluar penaltitetet për vonesat, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfitëoze të pasurive shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 pika III/ç, me VKM nr. 54, datë 5.02.2014 “Për dhënien me qira ose enfitëoze të pasurive shtetërore” dhe me nenin 3 të kontratave të qirave përkatëse.

Rekomandimi: Bashkia Bajram Curri të marrë masa për arkëtimin e vlerës **586,800 lekë mungesë të ardhurash** nga qiratë, përkatësisht; Qiramarrësi S.B. **99,600 lekë**, A.P. **259,200 leke** dhe T.H. e D.Gj. **228,000 lekë**, për shmangie të pagesës qirave të objekteve si rezultat i aplikimit më pak të tarifave ligjore për 100 leke/m² në vend të çmimit 200 lekë/m² që duhej, për mos arkëtimin e qirave për vitin 2014 dhe për shmangie të pagesës të sipërfaqes truallit funksional.

Deri me 31.03.2015

2. Gjetje: Në 5 raste është paguar vlera 3,000 lekë dëm ekonomik për arkëtaren V.D., pasi në mënyrë të paligjshme u është kthyer taksa vendore, e cila ishte arkëtuar më parë nga personat, sipas mandatpagesës nr. 5, datë 31.01.2013, veprim në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Rekomandimi: Për vlerën **3,000 lekë**, për arkëtaren V.Demiri, pasi ka paguar në mënyrë të paligjshme 5 familjarë për taksën vendore, të arkëtuar më parë nga personat, sipas mandatpagesës nr.5, datë 31.01.2013.

Deri me 30.01.2015

3. Gjetje: U konstatua vlera 40,000 lekë TVSH, për “D...” shpk, për shmangie pagesës TVSH, pasi subjekti ka prerë faturë jo të modelit tatimor me tvsh, por është mjaftuar me një faturë jashtë modelit tatimor nr.3, datë 23.4.2014, sipas urdhër shpenzimit nr.79, datë 25.5.2014, në kundërshtim me VKM nr.1149, datë 25.11.2009 “Për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentit tatimor”, me UMF nr.52, datë 28.12.2009 ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 7.01.2011, me ligjin nr. 8438, datë 28.11.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ndryshuar me ligjin nr. 8711, datë 15.12.2000 dhe ligjin nr. 8841, datë 11.12.2001.

Rekomandimi: Për vlerën **40,000 lekë TVSH**, për “Dardania” shpk, për shmangie pagesës TVSH, pasi ka prerë faturë jo të modelit tatimor me tvsh, por është mjaftuar me një faturë jashtë modelit tatimor nr.3, datë 23.4.2014, sipas urdhër shpenzimit nr.79, datë 25.5.2014.

Deri me 30.01.2015

4. Gjetje: U konstatua vlera 1,505,666 leke TVSH, përfituar tepër nga “E.E.” shpk, pasi është përfituar në mënyrë të dubluar TVSH-ja për 3 automjete (2 kamionët Benx dhe Fadromën) meqë TVSH-ja është likuiduar njëherë, dhe për çdo shitje nuk mund të aplikohet TVSH, pasi rritet fiktivisht vlera e automjeteve, sipas urdhër shpenzimeve nr.

37, datë 04.03.2013, nr. 224, datë 3.12.2013, nr. 87, datë 26.5.2014, faturës tatimore nr. 01213624, datë 04.01.2013 të subjektit dhe fletëhyrjes nr. 01, datë 04.01.2013.

Rekomandimi: Për vlerën **1,505,666 leke** për “E.E.” shpk, për përfitim të dubluar të TVSH për 2 kamionët Benx dhe 1 Fadromë sipas faturës tatimore nr. 01213624, datë 4.01.2013 të subjektit.

Deri me 30.02. 2015

5. Gjetje: Bashkia B.Curri për vlerën 1,400,410 lekë dëm ekonomik, ka likuiduar 2 subjekte shpk, për punë të pakryer për zërin *projekt-preventiv-supervizion*, në kundërshtim me kontratat përkatëse dhe me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandimi: Bashkia Bajram Curri të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,400,410 lekë**, për punë të pakryer për zërin *projekt-preventiv- supervizion*, përkatësisht nga 2 subjektet juridike:

- vlera 187,000 lekë , për subjektin “H..i” shpk, për sistemimin dhe asfaltimin e rrugës “Besëlidhja e Malësisë”, sipas situacionit nr.1 dhjetor 2011 dhe urdhër shpenzimit nr. 90, datë 5.03.2012,

-vlera 1,213,410 lekë për “F...” shpk, përkatësisht: 391,791 lekë për rikonstruksionin e shkollës 9-vjecare “Besëlidhja e Malesise”, sipas urdhër shpenzimit nr. 160, datë 3.05.2012 dhe situacionit përfundimtar datë 29.09.2011 të subjektit, dhe 821,619 lekë për sistemimin dhe asfaltimin e rrugës Agim Ramadani”, sipas urdhër shpenzimit nr. 161, datë 03.05.2012 dhe faturës nr.35, datë 16.04.2012.

6. Gjetje: U konstatua vlera 316,299 lekë dëm ekonomik pa T.V.SH për punime të pakryera, në kundërshtim me kontratën nr. 5 datë 14.11.2012 dhe nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, për subjektin juridik.

Rekomandimi: vlera **316,299 lekë**, për punime të pakryera, për bashkimin e OE “K..a” sh.p.k, “P.V.K.” sh.p.k dhe “Gj..a” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në tenderin me objekt “Rrugët e qytetit Bajram Curri, lagja Partizani (Unaza) faza I” sipas kontratës nr. 5 prot. në datë 14.11.2012.

Deri me 30.12. 2014

7. Gjetje: Në 25 raste vlera e ndërtimit të objektit sipas preventivit të paraqitur nuk është llogaritur duke u bazuar në manualet teknike të çmimit të punimeve të ndërtimit sipas VKM-së përkatëse ose çmimit për m2 sipërfaqe ndërtimi sipas EKB-së. Duke ju referuar të dhënave të projektit arkitektonik dhe çmimit për m2 sipas EKB-së rezulton se vlera e ndërtimit të objektit është më e lartë se ajo e përlllogaritur sipas preventivit apo situacionit përfundimtar, për rrjedhojë aplikuesit kanë paguar më pak për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 9,842,368 lekë dhe tarifën e aplikimit për leje zhvillimi në vlerën 2,045,097 lekë, të cilat përbëjnë dëm ekonomik të të arkëtueshëm nga kërkuesi në shumën 11,887,465 lekë.

Rekomandimi: Vlera prej **11,887,465 lekë**, nga aplikuesit /kërkuesit e lejeve zhvillimit/ndërtimit nga subjektet, sipas Aneksit nr.1, bashkëlidhur, për arsye se vlera e ndërtimit të objektit sipas preventivit të paraqitur nuk është llogaritur, duke u bazuar në

manuallet teknike të çmimit të punimeve të ndërtimit të miratuara me VKM përkatëse ose çmimit për m² sipërfaqe ndërtimi të përcaktuara nga EKB.

Deri me 30.01.2015

D. MASA DISIPLINORE

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013 miratuar me datë 30.5.2013, “Për nëpunësin civil” dhe dhe VKM nr. 115, date 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **rekomandojmë** që të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore sipas shkallës, **nga vrejtje deri në largim nga detyra, duke i lënë në kompetencën e kryetarit të Bashkisë Bajram Curri, për 19 punonjësit**, si më poshtë:

1. A.M. me detyrë n/kryetar bashkisë dhe në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kriteret të kualifikim-pranimit të operatorëve pjesëmarrës procedurat e prokurimit. Konkretisht, ka s`kualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta operator ekonomik, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla, pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues operator ekonomik, kur dokumentacioni i paraqitur për të vërtetuar kapacitetin ligjor është në kundërshtim me pikë 2 të nenin 44, me germen ç të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe me pikën 2 të Kreut VII të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1, që ka të bëjë, me mirë përdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke i bërë që **21,101,511 lekë** fonde buxhetore të mos përdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

-Trajtimi subjektiv i nenit 56 të LPP në lidhje me ofertat anomalisht të ulëta, ku konstatohet s`kualifikimi i operatoreve ekonomike, të cilët, sipas autoritetit kanë paraqitur oferte anomalisht të ulët, pa ju dhënë mundësia që të paraqesin shpjegimet në lidhje me ofertën përkatëse, ashtu siç parashikohet në favor të tyre nga LPP-ja. Kjo shpesh sjell një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të ligjit për prokurimin publik, kjo për vet faktin e pa mundësisë së paraqitjes të një argumentimi brenda afateve të ngushta kohore të dhëna nga autoriteti kontraktor.

2. V.H. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kritere të kualifikim-pranimin të operatorëve pjesëmarrës procedurat e prokurimit. Konkretisht, ka s`kualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin teknik për plotësimin e kritereve të veçanta operator ekonomik, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla, pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues operator ekonomik, kur dokumentacioni i paraqitur për të vërtetuar kapacitetin ligjor është në kundërshtim me pikë 2 të nenin 44, me germën ç të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” dhe me pikën 2 të Kreut VII të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirë përdorimin e fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke i bërë që **21,101,511 lekë** fonde buxhetore të mos përdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të shtetit.

-Trajtimi subjektiv i nenit 56 të LPP në lidhje me ofertat anomalisht të ulëta, ku konstatohet s`kualifikimi i operatoreve ekonomike, të cilët, sipas autoritetit kanë paraqitur oferte anomalisht të ulët, pa ju dhënë mundësi që të paraqesin shpjegimet në lidhje me ofertën përkatëse, ashtu siç parashikohet në favor të tyre nga LPP-ja. Kjo shpesh sjell një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të ligjit për prokurimin publik, kjo për vet faktin e pa mundësisë së paraqitjes të një argumentimi brenda afateve të ngushta kohore të dhëna nga autoriteti kontraktor.

-Për mangësitë lidhur me zbatimin e hapave për rishikimin e strukturave menaxheriale, dhe për mos përmbushjen e detyrimeve, gjatë viteve 2012, 2013, 2014 lidhur me zbatimin dhe implementimin e *ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*.

-Ka vepruar në kundërshtim me *UMF nr. 2/1, datë 15.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, shtojca 5*, pasi në vitin 2012 nga “Transferta e pakushtëzuar” për koston e personelit administrativë janë përdorur 28.7% nga 25% që është e lejuar.

-Për lejimin në 2 raste të pagesave të paligjshme për vlerën 200,000 lekë dëm ekonomik me veprimet e bankës, sipas urdhër shpenzimit nr. 78, datë 4.6.2014, në kundërshtim me pikën 1/b të VKM nr. 472, datë 02.7.2011”*Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore*” dhe me UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “*Për procedurat standarde zbatimit të buxhetit*”.

-Për likuidimin e padrejtë të vlerës 619,000 lekë dëm ekonomik, për punime të pakryera nga subjekti, të lëna ngarkim më parë nga KLSH, sipas shkresës saj nr.91/13, datë 31.05.2013 “*Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së*” shumë e ndalur nga financa e bashkisë dhe padrejtësisht i është likuiduar përsëri subjektit, sipas urdhër shpenzimit nr. 223, datë 3.12.2013, në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

3. H.I. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

